

VENDIM
Nr. 137, datë 6.6.2022

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “ALBANIAN GREEN ENERGY” SHPK PËR
RINOVIMIN E LICENCËS NR. 376, SERIA F17, NË VEPRIMTARINË E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, MIRATUAR ME VENDIMIN E
BORDIT TË ERE-s NR. 114, DATË 27.7.2012, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 20, germa “b”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2017; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.6.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 866/7, prot., datë 2.6.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘*Albanian Green Energy*’ sh.p.k., për rinovimin e licencës nr. 376, seria F17, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114, datë 27.7.2012, të ndryshuar”,

konstatoi se:

- Në respektim të afateve procedurale është përpiluar relacioni mbi refuzimin e kërkesës së shoqërisë “*Albanian Green Energy*” sh.p.k. për rinovimin e licencës nr. 376, seria F17, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114, datë 27.7.2012, të ndryshuar.

- Ndërkohë, në ERE ka mbërritur shkresa nr. 577/1 prot., datë 1.6.2022, nëpërmjet së cilës shoqëria “*Albanian Green Energy*” sh.p.k. ka përcjellë dokumentacion plotësues.

- Ndodhur në kushtet kur edhe afatet procedurale për këtë praktikë janë drejt përfundimit, vlerësohet se nevojitet koha e mjaftueshme për të shqyrtuar këtë dokumentacion dhe për të paraqitur më pas relacionin me propozimin përfundimtar, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “*Albanian Green Energy*” sh.p.k.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shtyjë me 10 (dhjetë) ditë pune vendimmarrjen përfundimtare të Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “*Albanian Green Energy*” sh.p.k. për rinovimin e licencës nr. 376, seria F17, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114, datë 27.7.2012, të ndryshuar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti